



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:715/25 Datë:20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohen programi e studimit i Kolegjit Fama, programi:

- *Psikologji e Përgjithshme, BA 180 ECTS (A).*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Fama brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik – bartësit si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Psikologji e Përgjithshme, BA 180 ECTS (A).</i>	Fleura Shkembi Halil Ajvazi Valbona Habili Sauku

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegji Fama.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master (tutje Manualit).

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Psikologji e Përgjithshme, BA 180 ECTS vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 11.04.2025 me këtë përbërje: *Kristijan Kask, Aysegul Kozak Cakir dhe Gaga Gvenetadze.*

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se nuk i përmbush kriteret për akreditim duke dhënë edhe rekomandimin se ky program nuk akreditohet:

- Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
- Nuk i përmbushë kriteret, një (1) fushë të standardeve të akreditimit;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 138-të, të mbajtur më datë 16.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të akreditimit për programet e lartë përmendura të Kolegjit Fama dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, vlerësimin, si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Fama;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,